

## Vendim nr. 256 datë 08.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 08.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (T) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** TOM DEDAJ, përfaqësuar nga avokat Gëzim Ceka me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3101, datë 16.07.2024 të Kolegjit Administrative të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/1, shkronja “f” dhe 134/1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 8, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Tom Dedaj (*kërkuesi*) në datën 02.02.2022 ka paraqitur kërkesëpadi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër/Peshkopi, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë me objekt “Plotësimin

dhe saktësimin e shënimeve në librezën e punës. Dhënien e pagës. Pagimin e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shumat e tjera që rrjedhin nga marrëdhënia e punës nga data 30.11.2018 e në vijim dhe vënien në ekzekutim të përkohshëm të vendimit”. Gjatë veprimeve paraprahe, me kërkesë të kërkuarit, është saktësuar objekti i padisë si vijon: “Njohjen e pavërtetësisë së shënimit të bërë në librezën e punës në emër të paditësit, në faqen 19 të saj në rubrikën “Largim nga puna”, në kolonën datë, muaj dhe viti, ku si datë e largimit nga puna është shënuar data 28.01.2019 dhe vënien në ekzekutim të përkohshëm të vendimit për kërkuarin”.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2692(80-2022-2750), datë 17.10.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova dhe ligj. Kundër këtij vendimi në datën 10.11.2022 ka paraqitur ankim kërkuari.

3. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 14.12.2022 dhe për të ende nuk është planifikuar datë gjykimi.

4. Në datën 27.05.2024 kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e tejkalimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3101, datë 16.07.2024, pasi ka kërkuar mendim nga gjykata e apelit për shkaqet e vonesës së shqyrtimit të kësaj çështjeje, ka vendosur rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive, që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, por se ajo ka qenë në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës totale të gjyqtarit, akumulimit ndër vite të dosjeve në gjykatë, si dhe shkurtimit për një kohë të konsiderueshme të numrit të gjyqtarëve në sistemin e drejtësisë.

6. Në datën 11.09.2024 kërkuari ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të saj.

## II

### Pretendimet e kërkuarit

7. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit është paraqitur në datën 10.11.2022, pra aktualisht ka kaluar 1 vit e 6 muaj dhe

ende nuk ka nisur shqyrtimi i saj në atë gjykatë. Po kështu, nga depozitimi i kërkesëpadisë në gjykatën e shkallës së parë deri në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë kanë kaluar 2 vjet e 9 muaj dhe ende nuk ka një vendim të formës së prerë. Kërkuesi është pezulluar nga detyra dhe ndërprerë paga padrejtësisht në datën 31.10.2016, pra ai ka pothuajse 8 vjet që zvarritet nëpër gjykata dhe prokurori.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kërkuesi si individ legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, për shkak se është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

10. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike efektive që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individi duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me

parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka paraqitur fillimisht kërkesë për përshpejtimin e gjykimit, drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, kërkesë e cila është rrëzuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2024-3101, datë 16.07.2024. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuetit për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

12. Për legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Kolegji konstaton se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i datës 16.07.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 11.09.2024 dhe pasi është plotësuar sipas kriterëve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.09.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, vërehet se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt, për shkak të tejzgjatjes së gjykimit të çështjes së tij në Gjykatën Administrative të Apelit, pretendim i cili, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

#### *B. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm*

14. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për shkak se ankimi në gjykatën administrative të apelit është paraqitur në datën 10.11.2022, pra aktualisht ka kaluar 1 vit e 6 muaj dhe ende nuk ka nisur shqyrtimi i saj. Po kështu, nga depozitimi i kërkesëpadsisë në gjykatën e shkallës së parë kanë kaluar 2 vjet e 9 muaj. Kërkuesi është pezulluar nga detyra dhe ndërprerë paga në datën 31.10.2016, pra ai ka pothuajse 8 vjet që zvarritet nëpër gjykata dhe prokurori.

15. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të

procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se procesi administrativ për çështjen e themelit që po shqyrtohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 02.02.2022. Pas dhënies nga ajo gjykatë të vendimit nr. 2692(80-2022-2750), datë 17.10.2022 për rrëzimin e kërkesëpadisë, kërkuesi ka paraqitur ankim i cili është regjistruar në gjykatën e apelit në datën 14.12.2022 dhe ndonëse ka kaluar 1 vit e 11 muaj, ende nuk ka një vendimmarrje për të.

17. Referuar nenit 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së, përbën afat të arsyeshëm përfundimi i gjykimit administrativ në gjykatën e apelit brenda një viti. Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor, ndaj për të vlerësuar arsyet e kësaj kohëzgjatjeje dhe për të arritur në përfundimin nëse kërkuesi i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, do të analizohen këto kritere: (i) sjellja e kërkuetit; (ii) kompleksiteti i çështjes; (iii) sjellja e autoriteteve; (iv) rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në lidhje me *sjelljen e kërkuetit*, Kolegji vëren se kërkuesi, pasi ka konstatuar se nuk është planifikuar një datë për shqyrtimin e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, në datën 03.06.2024 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e tejkalimit të afatit të arsyeshëm për shkak të vonesave në gjykimin e çështjes. Kjo kërkesë është rrëzuar nga Kolegji Administrativ në datën 16.07.2024 dhe sërish çështja ka mbetur pa veprime, në pritje të planifikimit për një datë shqyrtimi. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

19. Për sa i takon *kompleksitetit të çështjes*, Kolegji vëren se çështja ka natyrë administrative dhe kërkesëpadia ka në objekt të saj njohjen e pavërtetësisë së shënimit në librezën e punës së datës së largimit nga detyra të kërkuetit. Për rrjedhojë, duke iu referuar aspekteve të mësipërme, Kolegji vlerëson se ajo nuk paraqet kompleksitet të tillë që të justifikojë kohëzgjatjen e shqyrtimit të saj prej 1 viti e 11 muajsh në Gjykatën Administrative të Apelit.

20. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, duke mbajtur në konsideratë sa është theksuar nga Gjykata e Lartë për situatën aktuale të ngarkesës në sistemin gjyqësor, Kolegji konstaton se çështja e kërkuarit është në pritje për t'u gjykuar tashmë prej 1 viti e 11 muajsh në gjykatën e apelit, ndonëse ligjvënësi ka parashikuar afate procedurale konkrete në KPC. Gjykata e Lartë e ka rrëzuar kërkesën duke vlerësuar se mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, por se ajo ka qenë në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës totale të gjyqtarit, akumulimit ndër vite të dosjeve në gjykatë dhe shkurtimit për një kohë të konsiderueshme të numrit të gjyqtarëve në sistemin e drejtësisë. Sikurse arsyeton Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, relatori i çështjes, nëpërmjet shkresës nr. 2889, datë 24.06.2024, ka parashtruar se ka 2314 dosje që presin për t'u gjykuar prej tij dhe numri i tyre vjen në rritje. Aktualisht prej tij po gjykohen çështje të vitit 2017 sipas rendit kronologjik.

21. Së fundmi, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuari*, Gjykata ka vlerësuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përsheptim të posaçëm të gjykimit, nisur nga interesi veçanërisht i lartë i kërkuarit. Disa çështje që lidhen me interesa “*vetjakë e jetësorë*” nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi. Të tilla janë çështjet që kërkojnë “*kujdes të veçantë*” ose “*kujdes të jashtëzakonshëm*”, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme dhe pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuarit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024, nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin në shqyrtim, bazuar në argumentet e paraqitura në kërkesë, Kolegji vëren se kërkuari nuk ka paraqitur shkaqe të mjaftueshme për të provuar se çështja e tij është e një natyre të tillë që interesi i tij rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kjo çështje, për shkak të natyrës që ka, nuk lidhet me interesa *vetjakë e jetësorë*, të tillë që duhet të shqyrtohen me prioritet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuari* për shkak të vonesës së gjykimit të çështjes nga gjykata administrative e apelit, Kolegji çmon se kërkuari nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e tij, natyra dhe rëndësia e të cilëve të justifikojë trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së tij.

23. Nisur nga sa më lart, duke vlerësuar së bashku përfundimet e analizës të secilit prej standardeve të lartpërmendura kushtetuese, Kolegji vlerëson se në rrethanat e rastit konkret, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkuarit në Gjykatën Administrative të Apelit në raport me situatën aktuale të ngarkesës në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, si dhe me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuari, nuk duket të ketë tejkaluar një kufi kohor të arsyeshëm në aspektin kushtetues.

24. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuari nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.